



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE

Nr. _____ prot

Tiranë ____/____/2025

DREJTUAR: KOMISIONIT PËR EKONOMINË, PUNËSIMIN DHE FINANCAT

AMENDAMENT: “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.92/2014 “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 71 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë,
deputeti/ja _____,

Në projektligjin “Për disa Ndryshime në Ligjin Nr.92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar”, të bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

Neni 1

Neni 3, pika 1 dhe pika 3, riformulohen si më poshtë vijon:

Pika 1: “ *Janë subjekt i kësaj skeme:*

- a. Prodhuesit bujqësor që autofaturohen nga subjektet e TVSH-së;*
- b. Prodhuesit bujqësorë të cilët janë subjekte të TVSH-së dhe lëshojnë faturë shitjeje për produktet e shitura;*
- c. Prodhuesit bujqësorë që autofaturohen nga subjektet e biznes i vogël por që nuk janë subjekt i TVSH-së*

Subjektet e mësipërme lëshojnë faturë tatimore për shitësin, prodhues bujqësor, për cdo furnizim mallrash apo shërbimesh të marra prej tij. Vlera e faturës përfaqëson vlerën e furnizimit të paguar nga blerësi për llogari të shtetit, mbi të cilin aplikohet norma e kompensimit sipas këtij ligji;”

Pika 3: “*Kompensimi i akorduar i paguhet prodhuesit bujqësor nga administrata tatimore. Për të përfituar këtë kompensim, shitësi, prodhuesi bujqësor duhet të dorëzojë në administratën tatimore numrin e llogarisë së tij bankare.*

Kompensimi është i përmuajshëm dhe bëhet automatikisht nga ana e organeve tatimore në fund të muajit të vitit përkatës".

Neni 2

Neni 3, pika 4, shfuqizohet

Neni 3

Në nenin 69, pas shkronjes “c”, pika 1, shtohet shkronja “d me përmbajtje si më poshtë vijon:

“TVSH-në e përlllogaritur mbi vlerën përfundimtare të transaksionit për blerjen e produkteve bujqësore, nga personi i tatueshëm tek fermerët me autofaturim.

Për efekt të këtij ligji "vlera përfundimtare e transaksionit" është vlera për produktet bujqësore në transaksionin e blerjes së produkteve nga fermerët, në të cilën përfshihet dhe vlera e TVSH-së.

TVSH llogaritet duke pjesëtuar "vlerën përfundimtare të transaksionit" me koeficientin i cili llogaritet në bazë të formulës:

$$K=100 + \text{Norma e TVSH} / \text{Norma e TVSH}''$$

Neni 4

Në nenin 149, në pikën 3, fjalia “përgjatë një periudhe gjashtëmujore” zëvendësohet me fjalinë “përgjatë një periudhe njëmujore”.

Neni 5

Seksioni 4 i kreut 11, shfuqizohet

Neni 6

Këto shtesa dhe ndryshime reflektohen në të gjitha nenet e ligjit.

RELACION

PËR AMENDAMENTIN: PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.92/2014 “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË NDRYSHUAR”

Projektligji ka për qëllim të përmirësojë kuadrin ligjor të aplikimit të tatimit të vlerës së shtuar për implikimet që ka në sektorin e bujqësisë dhe një rregullim të ri në lidhje me mënyrën e llogaritjes së TVSH-së dhe zbritjes së TVSH-së, në rastet e autofaturimit në transaksionet e fermerëve me persona të tatueshëm.

Skema e kompensimit që propozon qeveria (10%) është vetëm një fraksion i problematikës me të cilën përballen fermerët shqiptarë.

Gjithsesi për ta plotësuar këtë skemë edhe me grupe/kategori të tjera fermerësh, ne propozojmë të futen në këtë skemë edhe katagoritë e renditura në nenin 1, pika 1 të këtij amendamenti.

Ndërkaq, koncepti i futjes së gjithë zinxhirit të prodhimit bujqësor në skemën e TVSH, është tjetër nga propozimi i qeverisë. Për të zgjidhur këtë gjë, ne kemi propozuar ndryshimet e tjera ligjore të renditura më sipër.

Objektivat kryesore që synohen të arrihen përfshijnë:

- Harmonizimin e bazës ligjore të TVSH-së dhe respektimi i konceptit të TVSH-së;
- Rregullimin e dispozitave ligjore të llogaritjes së TVSH-së dhe zbritjes së TVSH-së, në rastet e autofaturimit me burim nga marrëdhëniet me fermerët;
- Diskrimimin pozitiv të tregtarëve me status fermeri të cilëve shteti i lehtëson dhe nuk vendos detyrim të përlllogaritjes së TVSH-së dhe pagesës së TVSH-së në shitje;
- Krijimin e premisë për subvencionim direkt dhe real për fermerët;
- Rritjen e volumit të mbledhjes së TVSH-së nga formalizimi i qarkullimit të brendshëm të produkteve bujqësore;

- Garantimin e tatimit të drejtë dhe një konkurrencë të ndershme për tregtarët që shesin brenda vendit dhe agropërpunuesit që blejnë tek fermerët nëpërmjet autofaturës (përpunuesit e qumështit, mishit, perimeve, ullirit, drithrave etj).
- Shtimin e prodhimit bujqësor.
- Rritjen e konkurueshmërisë së produkteve vendase me ato të rajonit e për pasojë rritjen e eksporteve, rritjen e kërkesës për produktin vendas, rritjen e të ardhurave në zonat rurale (fshat) e rrjedhimisht rritjen e nivelit të jetesës në zonat rurale.
- Balancimin gradual të importit të prodhimeve bujqësore me prodhimin vendas.
- Mbështetjen e fermerëve, diversifikimi i aktiviteteve në zonat rurale dhe dhënien e impaktit pozitiv për industrinë përpunuese.
- Rivendos të drejtën dhe lirinë e çënuar të sipërmarrësve sepse i cliron nga detyrimi arbitrar për të kredituar pa interes nga likuiditeti i tyre fermerët për llogari të administratës tatimore.
- Të fusë në skemën e kompensimit (10%) edhe dy grupe të mëdha fermerësh si: prodhuesit bujqësorë të cilët janë subjekte të TVSH-së dhe lëshojnë faturë shitjeje për produktet e shitura, si dhe prodhuesit bujqësorë që autofaturohen nga subjektet e biznesit të vogël por që nuk janë subjekt i TVSH-së.

Deputeti/ja
